



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 2606 Prot.

Tiranë më 04.10.2021

V E N D I M

Nr. 09, datë 01.10.2021

“Për miratimin e Rregullores “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në Rektoratit e Universitetit të Tiranës”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36; Ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, neni 6, germa ç); Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 19/2016 “Për masat shpesh të sigurisë publike”, neni 5 dhe 8, si edhe në Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, në mbledhjen e datës 01.10.2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në Rektoratit e Universitetit të Tiranës”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

RREGULLORE

**“PËR MONITORIMIN, REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN
E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TË KAMERAVE, TË INSTALUARA NË
REKTORATIN E UNIVERSITETIT TË TIRANËS”**

Miratohet
Rektori i Universitetit të Tiranës

Prof. Dr. Artan Hoxha

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj Rregullore është përcaktimi i procedurave standarde dhe përgjegjësitë përkatëse lidhur me monitorimin, regjistrimin, transmetimin dhe administrimin e pamjeve që regjistrohen nëpërmjet Sistemit të Video Survejimit (këtu e më poshtë SVS), të instaluar në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, nga operatori ekonomik i kontraktuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me Sistemin e Video Survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 46, datë 28.3.2017 “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet sistemeve të sigurisë në zbatim të Ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, Rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës”, miratuar me Urdhrin Nr. 12, datë 08.6.2015 të Rektorit të UT-së.

Neni 3 Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat organizative dhe teknike lidhur me monitorimin, regjistrimin, transmetimin, administrimin e pamjeve që regjistrohen nëpërmjet SVS.
2. Rregullorja parashikon procedurat standarde dhe përgjegjësitë përkatëse lidhur me monitorimin, regjistrimin, transmetimin dhe administrimin e pamjeve që regjistrohen nëpërmjet SVS.
3. SVS mundëson monitorimin dhe regjistrimin në kohë reale të zonave dhe të ambjenteve ku është instaluar, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës,.

KREU 2
MONITORIMI, REGJISTRIMI DHE ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE TË SISTEMIT TË
KAMERAVE TË INSTALUARA NË REKTORAT.

Neni 4
Të dhënat e Sistemit të Video Survejimit

1. Sistemi SVS përbëhet nga 10 (dhjetë) kamera fikse Dahua, NVR të modelit DHI-NVR5432-4KS2, të vendosura në ambientet e Rektoratit të UT-së.
2. Sistemi duhet të punojë në mënyrë të pandërprerë, 24 orë në 24 orë.
3. Regjistrimi i pamjeve filmike të kamerave ruhet në aparaturë për regjistrim (NVR), që regjistron dhe ruan pamjet filmike deri në 32 ditë kalendarike.
4. Çdo 32 ditë aparatura për regjistrim (NVR) është programuar automatikisht të bëjë fshirjen e pamjeve filmike të regjistruara.
5. Aparatura për regjistrim (NVR), ndodhet në dhomën e serverave në godinën e Rektoratit të Universitetit të Tiranës.
6. Ambienti i brendshëm i dhomës së serverave, survejohet me kamera.

Neni 5
Mbikëqyrja dhe regjistrimi i imazheve

1. Mbikëqyrja dhe regjistrimi i imazheve nëpërmjet sistemit të video survejimit në ambiente të përbashkëta të godinave, lejohet vetëm për qëllimin e sigurisë së njerëzve dhe të ruajtjes së pronës.
2. SVS i Rektoratit të UT-së, përbëhet nga kamerat fikse dhe aparatura për regjistrim (këtu e më poshtë NVR).
3. Kontrolluesi, Universiteti i Tiranës, duhet të ketë të vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (modeli nr. 2), bashkëlidhur kësaj Rregullore.
4. Të dhënat e siguruar nga sistemi i kamerave janë konfidenciale. Ato nuk mund të zbulohen dhe përcillen, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 6
E drejta e aksesit në Sistemin e Video Survejimit

1. Të drejtën e aksesit në SVS e kanë:

- i. Të drejtën e aksesit primar në SVS, e ka Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave.
 - ii. Të drejtën e aksesit sekondar në SVS, e ka Përgjegjësi i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe/ose Specialisti i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.
2. Në zonën ku janë të vendosura pajisjet SVS, lejohet hyrja vetëm e personave të autorizuar nga Rektori i Universitetit të Tiranës.
 3. Personat të cilët kanë akses primar dhe sekondar në SVS, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për ruajtjen dhe mosbërjen publike të të dhënave për të cilat marrin dizeni në funksion të detyrës së tyre.
 4. Personat të cilët kanë akses primar dhe sekondar në SVS, kanë detyrimin të dokumentojnë me procesverbal çdo hyrje-dalje, arsyen dhe kohën e qëndrimit në SVS.
 5. Rektori i Universitetit të Tiranës, bazuar në një kërkesë me shkrim nga institucione të tjera të ngarkuara me ligj, mund të lejojë përdorimin e Sistemit të Video Survejimit (SVS) për ngjarje të veçanta me rëndësi për interesin publik dhe kombëtar (p.sh. parandalimi i akteve terroriste, etj) .

Neni 7

Masat teknike për ruajtjen e të dhënave fizike dhe teknologjike të SVS

1. Ruajtja e pamjeve filmike të SVS bëhet në aparaturën për regjistrim NVR, për një periudhë kohore deri në 32 ditë kalendarike.
2. Aparatura për regjistrim NVR ndodhet në dhomën e serverave të Rektoratit të Universitetit të Tiranës.
3. Dhoma e serverave ku ndodhet aparatura për regjistrim NVR, duhet të jertë e mbyllur me çelës gjatë gjithë kohës. Dhoma e serverave ku ndodhet aparatura për regjistrim NVR, survejohet me kamera nga brenda dhe në të nuk lejohet hyrja e personave të paautorizuar.
4. Godina e Rektoratit të Universitetit të Tiranës ruhet nga subjekt i ruajtjes së sigurisë fizike 24 orë.
5. SVS është i mbrojtur nga hakerimi (*ndërhyrja online me mjete kompjuterike e personave të paautorizuar*), pasi nuk është i lidhur *on line* në internet.

Neni 8

Administrimi i materialit të regjistruar

1. “Material i regjistruar” janë pjesë nga filmimet e kryera nga kamerat, të regjistruara në memorie elektronike apo të printuara, të cilat mund të shqyrtohen dhe përpunohen pas ngjarjes.
2. Të drejtën e aksesit në materialin e regjistruar, e kanë vetëm personat të cilët kanë akses primar dhe sekondar në SVS.

3. Materiali i regjistruar (pamjet filmike), i cili kërkohet në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, jepet vetëm me urdhër të Rektorit të Universitetit të Tiranës, bazuar në kërkesë të argumentuar me shkrim, nga personi përkatës i cili është regjistruar në pamjet filmike nga kamerat e SVS të Rektoratit të UT-së.
4. Kërkesa duhet të përmbajë informacione të detajuara për kërkuesin, arsyet dhe të dhënat mbi materialin e kërkuar (datën, kohën, vendin, etj.), bazën ligjore përkatëse, si dhe duhet t'i bashkëngjitet një fotokopje e kartës së identitetit të personit kërkues.
5. Fotokopja e kartës së identitetit, e cila i bashkëngjitet kërkesës nuk mund të ruhet më shumë se 2 muaj në Rektoratin e Universitetit të Tiranës.
6. Pas periudhës 2 mujore, fotokopja e kartës së identitetit duhet të asgjësohet dhe të mbahet procesverbali përkatës i asgjësimit.
7. Materiali i regjistruar (pamjet filmike), të cilat i jepen kërkuesit sipas kërkesës së paraqitur duhet të dokumentohet, duke mbajtur një procesverbal të nënshkruar nga të dy palët, i cili duhet të protokollohet.
8. Përcjellja e materialit të regjistruar (CD, USB, etj.), kryhet vetëm sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e plotë të të dhënave personale, të cilat duhet të jenë të paqarta, të padukshme dhe të palexueshme.

Neni 9

Ndryshimi dhe fshirja e pamjeve filmike

1. Aparatura për regjistrim NVR, ruan pamjet filmike për një periudhë të caktuar deri 32 ditë. Pas kësaj periudhe pamjet fshihen automatikisht nga sistemi.
2. Fshirja dhe ndryshimi i regjistrimit automatik të sistemit, me përjashtim të fshirjes që bën vetë sistemi, janë rreptësisht të ndaluara.
3. Të gjithë personave të cilët kanë të drejtën e aksesit në Sistemin e Monitorimit me Kamera, janë të detyruar të sigurojnë fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video – survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

Neni 10

Mirëmbajtja e Sistemit të Monitorimit me Kamera

1. Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave, siguron funksionimin e plotë dhe pa ndërprerje të sistemit, kushtet teknike të kërkuara, si dhe mirëmbajtjen e tij. Çdo kamera identifikohet me një numër IP ose emërtim sipas vendndodhjes. Mirëmbajtja e sistemit të monitorimit me kamera dhe pajisjeve të tij në zonat ku është instaluar, bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave.
2. Të gjitha pajisjet e sistemit duhet të jenë të inventarizuara.

3. Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave, koordinon dhe mbikëqyr shërbimin e mirëmbajtjes të sistemit të monitorimit me kamera.
4. Mirëmbajtja përfshin edhe riparim të rregullt periodik, të të gjitha pajisjeve dhe zëvendësimin e pajisjeve të cilave u kalon afati i shërbimit.
5. Mirëmbajtja duhet të sigurojë që asnjë pjesë e sistemit të instaluar, pavarësisht nga shkaku, të mos të lihet në gjendje jofunksionale përveç gjatë kohës së mirëmbajtjes dhe riparimit. Këto shërbime duhet të kryhen në një afat kohor sa më të shpejtë dhe të mirëkoordinuara, në mënyrë që ambientet e Rektoratit të UT-së, të mos mbeten të pa mbikëqyrura.

KREU 3 DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Kjo rregullore hyn në fuqi, pas miratimit nga Rektori i Universitetit të Tiranës.

ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA



Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar pranë:

(Emri i Kontrolluesit)

Subjekt i ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”

(Kontaktet e Kontrolluesit)

Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale apo cenim të privatësisë nëpërmjet sistemit të kamerave, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nr. i Gjelbër: 0800 20 50 www.idp.al info@idp.al

KËRKESË

Data

Lënda: *Për vënien në dispozicion të pamjeve filmike*
Drejtuar: *Rektoratit të Universitetit të Tiranës*
Baza ligjore: *Neni 3,11 ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më ___/___/_____,
banues në, _____, bazuar në nenin 3, 11 të ligjit nr.
119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të më vihen në dispozicion kopje të pamjeve
filmike të regjistruara në Sistemin e Video Survejimit të Rektoratit të Universitetit të
Tiranës, me datë ___/___/_____, në _____ vendin
_____, për arsye të mëposhtme:

Bashkëlidhur kopje të kartës së identitetit.

KËRKUES
